



## V E N D I M

Nr. 2, datë 23.06.2020

## PËR

**“MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË STRUKTURËN E AGJENCISË KOMBËTARE  
TË DIASPORËS DHE PROGRAMEVE TË RISHIKUARA TË AGJENCISË  
KOMBËTARE TË DIASPORËS PËR GJASHTËMUJORIN E DYTË TË VITIT 2020”**

Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit Nr. 115/2017 “Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, Këshilli Drejtues,

## VENDOSI:

1. Miratimin e një ndryshimi në strukturën e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, sipas propozimit bashkëlidhur, këtij vendimi.
2. Miratimin e programeve të rishikuara të Agjencisë Kombëtare të Diasporës për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2020, në vlerën 26.871.399 (njëzet e gjashtë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e një mijë e treqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë.

Rialokimi është për vlera brenda buxhetit vjetor, kursyer nga aktivitetet e parashikuara më pare në planin e aktiviteteve vjetore të Agjencisë, duke mundësuar zhvillimin e aktiviteteve shtesë, sipas prioriteteve dhe duke patur në konsideratë situatën e krijuar nga pandemia COVID-19.

Kjo vlerë është pjesë e mbetur e shumës prej 62.000.000 (gjashtëdhjetë e dy milion) lekë, pas pakësimit nëpërmjet Aktit Normativ Nr. 15, datë 15.04.2020, “Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 88/2019, “Për Buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar” dhe Aktit Normativ Nr. 28, datë 02.07.2020, “Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 88/2019, “Për Buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar”, pas realizimit të aktiviteteve të miratuara me Vendimin Nr. 01.datë 22.01.2020, të Këshillit Drejtues të Agjencisë Kombëtare të Diasporës (bashkëlidhur relacioni dhe tabela e detajimit të fondeve).



3. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Diasporës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyri në fuqi menjëherë,

### KËSHILLI DREJTUES

Etjen	XHAFAJ	<b>KRYETAR</b>
Rovena	VODA	<b>ANËTARE</b>
Anila	FERIZAJ	<b>ANËTARE</b>
Ornela	ÇUÇI	<b>ANËTARE</b>
Ada	ILIA	<b>ANËTARE</b>
Suzana	STEFA	<b>ANËTARE</b>
Kozeta	ANGJELIU	<b>ANËTARE</b>